REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 dhjetor 2019
Nr. ref.: RK 1470/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI197/18

Parashtrues

Ramadan Bislimi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 179/2018, të 23 gushtit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ramadan Bislimi nga fshati Dobërçan, Komuna e Gjilanit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 179/2018, të 23 gushtit 2018, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 104/2017, të 24 prillit 2018 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 1418/16, të 26 korrikut 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 18 dhjetor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 20 dhjetor 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gerxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 16 janar 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 6 nëntor 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se më 12 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës dhe „Vdek Group Online Trade" (në tekstin e mëtejmë: Vdek Group), me seli në Emiratet e Bashkuara Arabe, nënshkruan një kontratë të bashkëpunimit. Me këtë kontratë ka qenë e parashikuar që menaxhmenti i "Vdek Group" ia dërgon parashtruesit të kërkesës çeqet e udhëtarëve në shumë prej 500 dollarë, të cilat ai duhet t'i arkëtojë në bankat afariste në Kosovë, ku ai do t'i kthente dërguesit, përkatësisht "Vdek grupi", 90% të shumës së çekut të arkëtuar të udhëtarëve dhe do të mbante për vete 10% të shumës së çekut të arkëtuar të udhëtarëve në emër të pagës së tij mujore.

10. Më 21 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës e pranoi çekun e parë "American Express Travel Cheque" nga „Vdek Group", dhe e arkëtoi të njëjtin në filialin e Raiffeisen Bank në Gjilan.

11. Gjatë vitit 2011, parashtruesi i kërkesës arkëtoi një numër më të madh të çeqeve të udhëtarëve "American Express Travel Cheque", në filialin e njëjtë të Raiffeisen Bank, në shumë totale prej 27,930 dollarë.

12. Më 5 shtator 2011, në bazë të urdhrit (PN. nr. 5339/2011) të Gjykatës Themelore, Policia zbatoi bastisjen e shtëpisë së parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se në shtëpinë e parashtruesit të kërkesës mund të gjenden provat materiale për kryerjen e veprës penale „Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit" nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

13. Gjatë bastisjes së shtëpisë së parashtruesit të kërkesës, policia gjeti dhe sekuestroi 67 çeqe "American Express Travelers Cheque" në vlerë totale prej 33,500 USD, të cilët i konfiskoi së bashku me dëshmitë e tjera relevante.

14. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës është dëgjuar nga policia në cilësinë e të dyshuarit, dhe pas dëgjimit, sipas urdhrit të Kryeprokurorit, është ndaluar për 48 orë në Qendrën e Paraburgimit – Gjilan.

15. Më 7 shtator 2011, Policia e Kosovës, Sektori kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, paraqiti në Prokurorinë Publike Komunale (në tekstin e mëtejmë: PPK) në Gjilan, kallëzimin penal kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale *Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me nenin 1 të KPK-së.*

16. Më 20 shtator 2011, PPK paraqiti në Gjykatën Themelore në Gjilan aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale „Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit" nga neni 248 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

17. Më 1 qershor 2016, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin P. nr. 846/15, me të cilin e gjykoi parashtruesin e kërkesës me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 ditëve, të cilin e zëvendësoi me dënimin me gjobë në vlerë prej 1500 euro.

18. Me të njëjtin Aktgjykim, Gjykata Themelore e udhëzoi të dëmtuarën Raiffeisen Bank në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

19. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore P. nr. 846/15, ankesat në Gjykatën e Apelit i parashtruan PPK, e dëmtuara Raiffeisen Bank, si dhe përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

20. Më 14 nëntor 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin PA1. nr. 892/16, me të cilin i aprovoi pretendimet ankimore të PPK-së dhe të dëmtuarës Raiffeisen

Bank, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore P. nr. 846/15 dhe e ktheu çështjen në rigjykim.

21. Më 26 korrik 2017, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin P. nr. 1418/15, me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale. Rrjedhimisht, e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, të cilin nuk do ta mbante nëse brenda afatit prej 2 (dy) vitesh nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Me të njëjtin Aktgjykim, gjykata e obligoi parashtruesin e kërkesës që të dëmtuarës Raiffeisen Bank t'ia kthejë shumën prej 27,440 dollarëve amerikan.

22. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore thuhet: *„Gjykata me kujdes i shqyrtoi dhe i vlerësoi provat e administruara si dëshmitë e dëshmitarëve, mbrojtja e të akuzuarit, provat e administruara materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës konform nenit 260-262 të KPPRK-së duke i analizuar ato një nga një, dhe të gjithave së bashku si tërësi, ku besimin ia fali dëshmive të dëshmitarëve D. H, S. Rr, H. H, M. H, E. K. e posaqërisht të ekspertizës me shkrim të ekspertit Ibrahim Tahiri, i cili edhe të njëjtën e elaboroi me gojë, pastaj të gjitha shkresave tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe që shkojnë në favor të aktit akuzues, ku është i akuzuari pjesërisht edhe pamëdyshje pranon se i ka përdorur çeqet për mbules me pretekst se ai është i mashtruar e jo mashtruesi, e që të gjitha këto prova materiale pa mëdyshje e vërtetojnë gjendjen reale të përshkruar në aktakuzën, dëshmi këto bindëse, relevante dhe të pakontestueshme, që vërtetojnë se i akuzuari Ramadan Bislimi e ka kryer veprën e lartcekur penale, me dashje duke i sjellur vetit edhe dobi të kundërligjshme pasurore me vlerën e përafërt siq pohon përfaqësuesi i të dëmtuarës...".*

23. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ankesat i parashtruan Prokurori i Shtetit (në tekstin e mëtejmë: PSH) dhe mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës.

24. PSH e parashtroi ankesën lidhur me *„sanksionet penale nga neni 383 par. 1 nën. par. 1.4 lidhur me nenin 387 par. 1 të KPPRK, me propozim që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim me burg më të lart".*

25. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës e parashtroi ankesën *„për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në pikëpamje të vendimit mbi dënimin dhe i pandehuri Ramadan Bislimi në kuptim të nenit 364 par. 1 pika 1.1 dhe 1.3 të lirohet nga akuza...".*

26. Më 24 prill 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PA1. nr. 1042/2017, me të cilin i refuzoi si të pabazuara ankesat e PSH-së dhe mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

> ***"a)*** *Pretendimet e mbrojtësit se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet*

se ku është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike sidomos me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale.
b) *Sa i përket gjendjes faktike ankesa në këtë drejtim është po ashtu e pa bazuar për faktin se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike kur ka marrë aktgjykim dënues, pasi që pas administrimit të provave materiale dhe jo materiale siç janë deklaratat e dëshmitarëve si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit por edhe nga provat materiale siç janë fotokopjet e qeqeve, procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë së të akuzuarit, ekspertiza e forenzikës mbi çeçet false si dhe ekspertiza financiare nga të cilat pamëdyshje vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është gjykuar.*
c) *Sa i përket pretendimeve ankimore të prokurorit dhe mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës lidhur me lartësinë e dënimit, gjykata konkludoi se këto pretendime janë të pabazuara pasi që prokuroria por edhe mbrojtja nuk kanë paraqitur ndonjë arsye apo rrethanë të re e të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë por vetëm kanë theksuar se dënimi i shqiptuar nuk është i merituar sipas ligjit...".*

27. Mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke theksuar se **i)** aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të KPPK-së, meqenëse gjykata e shkallës së parë është mbështetur në prova të papranueshme të cilat janë mbledhur gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe, gjithashtu, **ii)** aktgjykimi i gjykatës nuk është i qartë dhe i përpiluar sipas dispozitës nga neni 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të KPPK-së.

28. PSH përmes parashtresës së tij kërkoi nga Gjykata Supreme që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.

29. Më 23 gusht 2018, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 179/2018, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

Në lidhje me pretendimin e parë në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë *i) "Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk bazohet në provë të papranueshme siç pretendohet në kërkesë meqë procesverbalin e bastisjes së banesës së të dënuarit e ka nënshkruar dëshmitarja A. Sh, e për më tepër, edhe vet i dënuari ka dhënë pëlqimin për dorëzimin e çeqeve të cilat i kishte në shtëpinë e tij.*

Në lidhje me pretendimin e dytë në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë *ii) Gjykata konkludon se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë të gjitha faktet janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për secilin fakt janë paraqitur të dhëna të arsyetuara në secilën pikë të aktgjykimit dhe janë dhënë arsyetime lidhur me faktet e vërtetuara dhe të pavërtetuara. Në mënyrë mjaft të detajuar janë vlerësuar të gjitha provat materiale, çeqet e konfiskuara dhe raporti i ekspertizës, si dhe deklaratat e dëshmitarëve të cilave gjykata iu fali besimin".*

Pretendimet e parashtruesit

30. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në të gjitha fazat e procedurës penale e cila është zbatuar para gjykatave të rregullta.

31. Më konkretisht, shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së para Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës e arsyeton me pretendimin se *„vetë bastisja e shtëpisë nga policia ka qenë e paligjshme, se ai në procedurën penale është cilësuar si kryes i veprës penale, ndërsa ai në fakt është viktimë, se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk përmban asnjë përgjigje, analizë apo shtjellim".*

32. Më tej, shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së para Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës e arsyeton me pretendimin *„se as aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk përmban asnjë përgjigje lidhur me bastisjen e paligjshme të shtëpisë, se aktgjykimi nuk përmban një analizë apo shtjellim që do të dëshmonte se ky pretendim është shqyrtuar, si dhe që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk është i arsyetuar dhe nuk ofron përgjigje lidhur me çështjet thelbësore që kanë të bëjnë me faktin se ai nuk ka pasur dijeni që ato janë çeqe të falsifikuara".*

33. Më tej, shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së para Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës e arsyetohen me pretendimin se *„sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme nuk është marrë me çështjen e bastisjes së paligjshme të banesës, e cila ka qenë tërësisht e jashtëligjshme për shkak të falsifikimit dhe mungesës së dëshmitarit, sikurse e kërkon ligji (neni 108.2 i Kodit të Procedurës Penale) dhe përpilimit të dy procesverbaleve (ku njëri është domosdoshmërisht i falsifikuar). Andaj, provat që janë përfituar nga Policia në shkelje të ligjit nuk janë proceduralisht të pranueshme në Gjykatë dhe rrjedhimisht gjykata e apelit nuk mund të mbështetej në to".*

34. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për aktgjykim të arsyetuar si një nga elementet e nenit 6 të KEDNJ-së, dhe në mbështetje të kësaj, parashtruesi shton se në *"Aktgjykimin Hadjianastassiou kundër Greqisë, GJEDNJ ka theksuar se vendimet e arsyetuara shërbejnë për t'i treguar palëve se ato janë dëgjuar nga gjykata".*

35. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 6.1 të KEDNJ-së për shkak të përmbysjes së barrës së provës dhe në mbështetje të kësaj thekson se *"parimi i prezumimit të pafajësisë parashikon, ndër të tjera, që është detyrim i prokurorisë që të paraqesë prova të mjaftueshme për ta dënuar të akuzuarin (Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, paragrafi 77 dhe Janosheviq kundër Suedisë, paragrafi 97)".*

36. Dhe, si pretendimin e fundit, parashtruesi i kërkesës thekson se ai nuk ka pasur një procedurë të drejtë gjyqësore për shkak se është dënuar në bazë të provave të marra në shkelje të ligjit.

37. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të shfuqizojë aktgjykimet e kontestuara dhe të kthejë çështjen në rigjykim pranë Gjykatës Themelore, ose të shfuqizojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

40. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> Neni 47
> [Kërkesa individuale]
>
> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
>
> Neni 48
> [Saktësimi i kërkesës]
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

41. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

42. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 179/2018, të 23 gushtit 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka theksuar të drejtat dhe liritë për të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret e paraqitura në nenin 48 të Ligjit dhe e dorëzoi kërkesën brenda afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

43. Duke marrë parasysh vetë thelbin e kërkesës së parashtruesit, Gjykata vëren se ai në kërkesën e tij kishte ngritur disa pretendime për shkeljen e të drejtave dhe lirive kushtetuese lidhur me nenin 31 të Kushtetutës, si dhe për shkeljen e të drejtave të parashikuara me nenin 6 të KEDNJ-së.

44. Duke pasur parasysh se procedura nga e cila ka rezultuar Aktgjykimi i kontestuar kishte të bënte me vërtetimin e bazueshmërisë së akuzës penale kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale *"Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit"*, rrjedh se parashtruesi në procedurë i gëzon garancitë e së drejtës për gjykim të drejtë nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Duke marrë parasysh këto, Gjykata në rastin konkret do të shqyrtojë nëse procedura ka qenë e drejtë në mënyrën siç kërkohet me dispozitat e përmendura.

45. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, rrjedh se ai në thelb konteston drejtësinë e procedurës si një tërësi, pasi që konsideron se në procedurën nga e cila ka rezultuar Aktgjykimi i kontestuar, provat janë vlerësuar në mënyrë arbitrare, në veçanti provat e mbledhura gjatë bastisjes policore të paligjshme të banesës, gjithashtu, se në Aktgjykimin e kontestuar nuk është vërtetuar fare raporti i tij subjektiv ndaj veprës së kryer, ku ai ka qenë viktimë e mashtrimit dhe jo kryesi i veprës penale, se gjykatat e rregullta nuk i kanë arsyetuar aktgjykimet e tyre në përputhje me parimin e GJEDNJ-së, se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i kanë vlerësuar provat në mënyrë arbitrare, duke i pranuar si të vërtetuara faktet për të cilat, sipas mendimit të tij, ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm, duke e ngarkuar mbi të barrën e provës për të provuar pafajësinë e tij, dhe jo mbi prokurorinë e cila është dashur të provojë fajësinë e tij si personit të pandehur.

46. Gjykata, para së gjithash, rikujton se në vendimet e saj të mëparshme, duke u mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në

tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), konkludoi se çështja nëse i akuzuari ka pasur një procedurë të drejtë duhet të merret në konsideratë në bazë të tërë procedurës, dhe se garancia e përgjithshme e „gjykimit të drejtë" nga paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së ka elemente që plotësojnë garancitë specifike të përcaktuara me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, GJEDNJ, *Artico kundër Italisë,* A 37 (1980)). Kur kemi të bëjmë me rastin i cili hyn në një nga garancitë specifike të vendosura me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 6, ai mund të shqyrtohet ose në kuadër të këtyre garancive (shih, GJEDNJ, *Luedicke kundër FRG,* A 29 (1978), 2 EHRR 149), ose në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (shih, GJEDNJ, *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar,* 1996-III, 22 EHRR 293 GC).

47. Megjithatë, nëse kërkesa lidhet thelbësisht me pretendimin se procedura në tërësi, duke përfshirë edhe procedurën ankimore, ka qenë e padrejtë, pretendimet shqyrtohen në kuptim të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, GJEDNJ, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar,* A 247-B (1992), 15 EHRR 417, par. 33-34).

48. Duke pasur parasysh se parashtruesi në rastin konkret ngre çështje në lidhje me garancitë e vendosura me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Konventës Evropiane, të cilat, në thelb, kanë të bëjnë me pretendimin se procedura në tërësi nuk ishte e drejtë, Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh standardet e lartpërmendura të GJEDNJ-së, do t'i shqyrtojë pretendimet e tij në kuptim të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

49. Lidhur me këtë, Gjykata gjen se parashtruesi në kërkesën e tij i kishte radhitur pretendimet e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në disa pretendime të veçanta, të cilat i arsyetoi veç e veç në kërkesë. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i shqyrtojë veçmas të gjitha këto pretendime në raport.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së lidhur me bastisjen e banesës dhe përdorimin e provave

50. Sa i përket pretendimit të parë të parashtruesit të kërkesës se bastisja e banesës, e cila është kryer më 5 shtator 2011 nga policia, është e paligjshme dhe se rrjedhimisht provat të cilat janë mbledhur me atë rast janë gjithashtu të paligjshme dhe nuk mund të përdoren kundër tij gjatë gjykimit, Gjykata së pari vëren se bastisja e banesës së parashtruesit të kërkesës është kryer nga Policia e Kosovës në bazë të urdhrit (PN. nr. 5339/2011) të Gjykatës Themelore për shkak të dyshimit të bazuar se në banesën e parashtruesit të kërkesës mund të gjenden provat se ai e ka kryer veprën penale. Për më tepër, gjatë bastisjes së banesës, policia i ka gjetur provat dhe me atë rast përpiloi procesverbalin për të gjitha sendet e sekuestruara që i ka konsideruar relevante si material provues kundër parashtruesit të kërkesës, gjë që është në pajtim me nenin 108.7 të KPP-së.

> *"Neni 108.7. Për çdo kontroll të personit, të shtëpisë ose të lokaleve përpilohet procesverbali. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga personi i kontrolluar ose nga personi, lokalet apo pasuria e të cilit është kontrolluar, avokati i tij nëse është i pranishëm gjatë kontrollit dhe personat, prania e të cilëve është e detyruar. Gjatë zbatimit të kontrollit mund të konfiskohen*

vetëm sendet dhe shkresat lidhur me qëllimin e kontrollit të caktuar. Sendet dhe shkresat e konfiskuara përfshihen dhe përshkruhen qartë në procesverbal dhe shënohen në vërtetimin që menjëherë i jepet personit sendet dhe shkresat e të cilit janë konfiskuar".

51. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton se me dispozitën e nenit 60 paragrafi 1 të KPK-së rregullohet edhe çështja e marrjes së sendeve që janë përdorur apo kanë qenë te dedikuara për përdorim në kryerjen e veprës penale:

„1. Sendet të cilat janë përdorur apo janë dedikuar për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale mund të merren nëse janë pronë e kryerësit".

52. Gjykata, më tej, vëren se në procedurën para Gjykatës Themelore janë shqyrtuar të gjitha provat dhe materiali provues i konfiskuar gjatë bastisjes policore, janë dëgjuar dëshmitarët e drejtpërdrejtë, si dhe ekspertët gjyqësor, dhe gjithashtu në mënyrë të veçantë është marrë në konsideratë deklarata e parashtruesit të kërkesës e dhënë gjatë procedurës së dëgjimit para policisë ku ai *„nuk e mohon faktin se ato qeqe i kishte përdorur duke pohuar se nuk e kishte ditur se janë të falsifikuara".*

53. Sa i përket vetë materialit provues i cili është përdorur nga Gjykata Themelore gjatë përcaktimit të përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se është përtej juridiksionit të saj që të vlerësojë cilësinë e konkluzioneve të gjykatave lidhur me vlerësimin e provave, nëse ky vlerësim nuk duket të jetë qartazi arbitrar. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese nuk do të ndërhyjë as në mënyrën se si gjykatat e rregullta i kanë pranuar provat si material provues. Gjykata Kushtetuese nuk do të ndërhyjë në situatën kur gjykatat e rregullta u besojnë provave të njërës palë në procedurë në bazë të vlerësimit të lirë të gjyqtarit. Ky është rol ekskluziv i gjykatave të rregullta, madje edhe kur deklaratat e dëshmitarëve në shqyrtimin publik dhe nën betim janë në kundërshtim me njëra-tjetrën (shih, GJEDNJ, *Doorson kundër Holandës,* Aktgjykim i 6 marsit 1996, i publikuar në raportet numër 1996-II, paragrafi 78).

54. Gjykata gjithashtu vëren se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit nuk i mori në konsideratë pretendimet e tij për provat e konfiskuara gjatë bastisjes policore të banesës së tij. Lidhur me këtë, Gjykata e Apelit gjeti se *"provat e cekura më lartë demantojnë pretendimet e mbrojtjes në drejtim të mohimit të veprës penale, pasi nga provat të cilat u administruan e që u arsyetuan nga ana e gjykatës së shkallës së parë pamëdyshje u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 248 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPK".*

55. Për më tepër, edhe Gjykata Supreme në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë është marrë me çështjen e paraqitur nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, e cila lidhet pikërisht me çështjen e provave që pretendohet se janë mbledhur gjatë bastisjes së paligjshme. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme konkludoi se *"aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk bazohet në provë të papranueshme siç pretendohet me kërkesë meqë procesverbalin e bastisjes së të dënuarit e ka nënshkruar dëshmitarja A. Sh., e për më tepër, edhe vet i*

dënuari ka dhënë pëlqimin për dorëzimin e çeqeve të cilat i kishte në shtëpinë e tij".

56. Në lidhje me këtë, Gjykata konkludon se nuk janë të bazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me bastisjen e paligjshme të banesës dhe marrjen e sendeve të cilat gjatë procedurës penale janë përdorur si material provues kundër tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me aktgjykimet e paarsyetuara gjyqësore

57. Gjykata vëren se shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me aktgjykimet e paarsyetuara, parashtruesi i kërkesës e ndërlidh me faktin *„se gjatë procedurës pranë gjykatave të rregullta, ai ka theksuar se është viktimë dhe jo kryesi i kësaj vepre penale. Gjykatat e rregullta kanë vendosur se ai është kryesi i veprës penale, por asnjë arsyetim cilësor, intelektualisht i pranueshëm dhe i shëndoshë nuk është dhënë prej tyre".*

58. Lidhur me këtë, Gjykata së pari thekson se, sipas praktikës së vendosur të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat, ndër të tjera, të arsyetojnë aktgjykimet e tyre. Ky obligim, megjithatë, nuk mund të kuptohet si detyrim që në aktgjykim të paraqiten të gjitha detajet dhe të jepen përgjigje në të gjitha pyetjet dhe argumentet e paraqitura. Masa në të cilën ekziston ky obligim varet nga natyra e vendimit (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, të 9 dhjetorit 1994, seria A, numër 303-A, paragrafi 29; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61).

59. GJEDNJ dhe Gjykata Kushtetuese në vendimet e shumta kanë treguar se gjykatat vendore kanë një vlerësim të caktuar diskrecional në lidhje me atë se cilat argumente dhe prova do t'i pranojë në rastin e caktuar, por njëkohësisht kanë edhe obligimin ta arsyetojnë vendimin e tyre, duke ofruar arsye të qarta dhe të kuptueshme mbi të cilat e kanë bazuar atë vendim (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Suominen kundër Finlandës,* të 1 korrikut 2003, kërkesa numër 37801/97, paragrafi 36).

60. Duke i ndërlidhur paragrafët e mësipërm me rastin konkret, Gjykata vëren se në aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk mungon arsyetimi, si për çështjen e materialit të mbledhur provues, argumenteve të paraqitura dhe provave të mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës, ashtu edhe për çështjen e dëgjimit të dëshmitarëve dhe ekspertëve në lidhje me çështjen e ekspertizës së çeqeve të konfiskuara ku është vërtetuar origjinaliteti i tyre.

61. Gjithashtu, Gjykata nuk gjen se në aktgjykimet e kontestuara mungon arsyetimi për çështjen e vendimeve të cilat janë marrë nga gjykatat në lidhje me vërtetimin e përgjegjësisë penale të parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht, në aktgjykimet nuk mund të vërehet se ekzistojnë paqartësi rreth çështjes së arsyeve mbi të cilat bazohen këto vendime.

62. Për më tepër, Gjykata Supreme lidhur me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës konkludoi se *"edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha pretendimet ankimore dhe me të drejtë janë refuzuar këto pretendime dhe, për më tepër, në mënyrë të detajuar është arsyetuar secila pikë e pretendimeve ankimore, ashtu që të gjeturat e gjykatës së shkallës së dytë në tërësi i aprovon edhe Gjykata Supreme e Kosovës"*.

63. Rrjedhimisht, Gjykata i gjen të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta nuk i kishin arsyetuar aktgjykimet e tyre dhe se për shkak të kësaj është shkelur neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

64. Sa i përket pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës në lidhje me barrën e provës dhe pretendimin se ai nuk ka pasur një procedurë gjyqësore e cila është e drejtë në tërësi, Gjykata thekson se ajo nuk do të merret me këto pretendime veç e veç, sepse në bazë të arsyetimit tashmë të dhënë rezulton se edhe këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara.

65. Rrjedhimisht, Gjykata, mbi bazën e të gjitha të lartcekurave, konsideron se gjykatat e rregullta e respektuan obligimin e tyre nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së dhe për këtë arsye janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se me vendimet e kontestuara është shkelur e drejta për gjykim të drejtë në këtë segment.

66. Gjykata gjen se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedura në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme ishte e padrejtë apo arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesit të kërkesës i është mohuar ndonjë garanci procedurale, që do të çonte në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, përkatësisht me nenin 6 të KEDNJ-së.

67. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë ndonjë provë *prima facie* që tregon për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla,* të 5 dhjetorit 2013).

68. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues | **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Safet Hoxha | Arta Rama-Hajrizi